

## Orkestra Simfonike e Akademisë së Arteve

### Violina e parë

Miron PEKU  
Ajllinda MATAJ  
Brigit CANGONJI  
Rozarta LUKA  
Margret RADOVANI  
Eriola HAKA  
Stela BEGO  
Volfi HAXHIAJ  
Loren VOCKA  
Sonja ALISINANI

### Violina e dytë

Ramazan PEKU  
Edmea KRASNIQI  
Aldo META  
Eldi SHEHU  
Irv GURRA  
Ilva HAXHIU  
Jeton KACKA  
Anxhela DERVISHI  
Xhina ÇELA  
Lisiona MEZINI

### Viola

Arian PAÇO  
Etleva MAQELLARI  
Albion VUKA  
Erida JUSUFAJ  
Mimoza SELAJ  
Gilmona BRUZI

### Violonçel

Aristidh PROSI  
Dorina LARO  
Blerina DYRMISHAJ  
Adriana GRUJA  
Lorela KËRCIKU  
Fatjon KOTORRI  
Ejona NAKO  
Igert ZEQRIRI

### Kontrabass

Arben BASHA  
Elvis CARA  
Oltion LILA  
Ermal JAUPI  
Tonin KOLA

### Flaut

Vjollca ISMAILAJ  
Ethem HOXHOLLI  
Xhejsi KALZIQI

### Oboe

Ilir GJOKA  
Dea TABAKU  
Donika SINANI

### Video-shkrim muzikor

Altin BULI  
Dorian ÇENE  
Bujar ALLIU  
Eugen MUMAJESI  
Alban DHAMO  
Ergys PIRANI  
Dorian ULAJ

## Koncert ACADEMY GRAND-GALA

### Klarinet

Bashkim BARBULLUSHI  
Sokol TOTO

### Fagot

Pirro SOTA  
Fatos JAHO  
Fatlum BAJRAKTARI

### Corno

Andrea CANAJ  
Ilir KODHIMA  
Taulant HAXHIAJ  
Irgenta DERVISHAJ

### Tromb

Taulant HAJRO  
Taulant HATIJA

### Trombon

Romeo MANO  
Alban ZADEJA  
Etrit ADAMI

### Timpan

Gridi KRAJA

### Piano

Xheni AFEZOLLI



## Koncert ACADEMY GRAND-GALA



Me pjesëmarrjen e sopranove  
Suzana FRASHËRI  
Shqipe ZANI  
Mariana LEKA

Soliste e ftuar  
Pianistja Nora ÇASHKU  
Dirigjent  
Petrika AFEZOLLI

www.emardesign.eu



Datë 22 dhjetor 2010  
Ora 20:30  
Salla a Akademisë së Arteve



Qyteti  
i Arteve

Ky aktivitet mundësohet  
me mbështetjen financiare  
të projektit "Qyteti i Arteve"



## Suzana Frashëri

Soprano

Më 1977 mbaron studimet në degën e Kantos në Institutin e Lartë të Arteve (sot Akademia e Arteve Tiranë) me Prof. Juljian Bajesu (Rumani) dhe Gjoni Athanas.

# Koncert ACADEMY GRAND-GALA

Më 1985-87 kryen specializimin pasuniversitar për pedagogjinë vokale në konservatorin Santa Cecilia në Romë në drejtimin e prof. Valerio Paperi. Karriera e saj artistike përfshin shumë koncerte brenda dhe jashtë vendit si në Itali, Greqi, Slloveni, Kroaci, Gjermani, Sh.B.A., Izrael etj, me formacione të muzikës së dhomës dhe me orkestra simfonike, si orkestra e filarmonisë së Beogradit, filarmonisë së Izraelit, e filarmonisë së Shkupit, Akademisë së Arteve, e TOB, "New Sounds", etj; me dirigjentë shqiptarë si F. Deda, E. Krantja, B. Llapaj, P. Afezulli, A. Lepuri, Zh. Ciko etj, si dhe me dirigjentë të huaj si Stiven Barlow, Doron Solomon, Nikos Eftimiadhis, Leonado Kuadrini, etj.

Vlen të përmenden gjithashtu bashkëpunimet e shpeshta me koncertmaestër R. Radoja, A. Tartari, M. Rexha, M. Kongo, R. Ciko, I. Laço etj. Soliste koncertiste me nje repertor shumë të gjerë veprash, një pjesë e konsiderueshme e të cilave përbejne fondin e regjistrimeve të Radio-Televizionit Shqiptar.

Një veçanti e këtij repertori janë gjithashtu realizimet e premierave të muzikës së dhomës të autorëve si Pergolezi, A. Vivaldi, V. Bellini, G. Verdi, G. Fauré, A. Part etj. Fituese e çmimit "Ballkanik" Greqi, 1993; e çmimit të parë në festivalin "T. Harapi" 1996; e çmimit si interpretuesja më e mirë në festivalin e "Muzikës shqiptare" akorduar nga fondacioni Dh.Leka 1997, si edhe e vlerësuar me diskun e Artë nga "Panteoni Jess". Që prej vitit 1987 punon si pedagoge e belkantos në Akademinë e Arteve në Tiranë dhe gjatë viteve 1999 – 2007 ka drejtuar katedrën e Kantos në këtë institucion.

Aktualisht është profesore pranë këtij institucioni dhe ndër studentët e saj më të spikatur, mund të përmenden artiste me karrierë si Enkelejda Shkoza, Alketa Çela, Ermonela Jaho, Miriam Tola, Oriana Kurteshi, Erla Kollaku, Etleva Shemaj, Gëzim Myshketa, Shpresa Beka, Eriona Gjyzeli, Ramona Tullumani etj.



## Shqipe Zani

Soprano

Pas studimeve në Liceun artistik dhe Konservatorit Tiranë në Degën Kanto, dhe në vijim pas perfundimit të stazhit një vjeçar në trupën e Solistëve në mënyrë të vazhdueshme është kualifikuar Tempus në Akademinë Santa Cecilia dhe Akademinë e Arteve, Romë, Itali.

Me një karrierë të pasur artistike që prej vitit 1974 e në vijim, spikat si Soliste e talentuar në Teatrin e Operës dhe Baletit duke interpretuar në role të fuqishme e plot ngjyra si ai i Davës, në veprën e Preng Jakovës, atë të Lules në "Zgjimin" e Tonin Harapit, Afrovitin e Avni Mulës; Elin e Mingës; etj Toskën, Muzetën, Çoçasanin në veprat e Xhakomo Puçinit; Fraskiten të "Karmen" i Zhorzh Bize; Xhildën në "Rigoleton" dhe Leonorën në "Trovatoren" e Verdit; Rozinën e Rosinit; Nedën të Paliçi i Kavalos; etj

- 1987** Aktualisht Pjesëmarrëse në të gjitha edicionet e Festivalit të Romancës shqiptare.
- 1992** Aktualisht Aktivitete koncertale në piano e orkestrë.
- 1998 - 2009** Pjesëmarrëse në të gjitha edicionet e Festivalit Chopen.

Ndër çmimet e akorduara në aktivitetin e saj përmenden:

- 1985** Urdhri Naim Frashëri, Klasi III, për Interpretim të Lartë të Muzikës Shqiptare dhe Popullore e Përpunuar,
- 1988** Çmimi i Dytë Konkursi "Tefta Tashko", Korçë
- 1977-78-79** Çmimi i parë dhe i dytë Festivali i Këngës Popullore të përpunuar.
- 1981-82-83** Çmimi i parë dhe i dytë Dekada e Majit
- 2000** Qytetar nderi Gramsh
- 2007** Akordohet titulli "Profesor"

Që prej vitit 1974 dhe aktualisht ka realizuar rregullisht pothuaj përvit turne në aktivitetet ndërkombetare si në Itali, Maqedoni, Kosovë, Mal i Zi, Kinë, Kore, Turqi, Tunizi, Egjipt, Angli, etj.



## Mariana Leka

Soprano

Eshtë diplomuar për kanto në Konservatorin e Tiranës nën udhëheqjen e Edit Mihalit. Nisi karrieren e saj artistike me debutin e Violetës "Traviata", në Teatrin e Operës, Tiranë, duke u bërë kështu pjesë e trupës së Teatrit si Solist Soprano.

# Koncert ACADEMY GRAND-GALA

Repertori i saj i gjerë operistik përmbledh rolet:

<b>Xhilda</b> - Rigoletto - <b>G.Verdi</b>	<b>Adina</b> - L'elisir d'amore - <b>G.Donizetti</b>
<b>Leila</b> - Les pescheures de perles - <b>G.Bizet</b>	<b>Mimi</b> - La Boheme - <b>G.Puccini</b>
<b>Zerlina</b> - Don Giovanni - <b>W.A.Mozart</b>	<b>Cio Cio San</b> - Madama Butterfly - <b>G.Puccini</b>
<b>Suzana</b> - Le nozze di figaro - <b>W.A.Mozart</b>	<b>Liu</b> - Turandot - <b>G.Puccini</b>
<b>Fiordiligi</b> - Cosi fan tutte - <b>W.A.Mozart</b>	<b>Norma</b> - Norma - <b>V.Bellini</b>
<b>Sofia</b> - Il signor Bruschino - <b>G.Rossini</b>	<b>Margherita</b> - Faust - <b>G.Gounod</b>
<b>Micaela</b> - Karmen - <b>G.Bizet</b>	<b>Pamina</b> - Die Zaubeflute - <b>W.A.Mozart</b>
<b>Clarice</b> - Il mondo della luna - <b>F.J.Haydn</b>	<b>Amelia</b> - Un ballo in maschera - <b>G.Verdi</b>

Muziken e dhomës:

Stabat Mater - <b>G.Rossini</b>	Magnificat - <b>A.Vivaldi</b>
Stabat Mater - <b>G.P. Pergolesi</b>	Suor Angelica - <b>Puccini</b>
Requiem - <b>W.A.Mozart</b>	Lucia di Lommermoor - <b>Donizetti</b>
Salve Regina - <b>G.P.Pergolesi</b>	<b>Desdemona</b> - Otello - <b>G.Verdi</b>
The mesiah - <b>G.F Handel</b>	<b>Ana Bolena</b> - Ana - <b>G.Donizzetti</b>

Fituese e shumë çmimeve dhe konkurseve Ndërkombëtare:

- 1992** Çmimi Katia Riciarelli, Mantova, Itali
- 1996** Çmimi i parë Konkursi Ndërkombëtar i Operës italiane, Stutgard (Gjermani)
- 1999** Çmimi i parë Festivali Internacional i Zërave Lirike "Marie Kraja" Tiranë
- 2005** Kult 2005 si Këngëtarja më e mirë lirike e vitit 2005, Tiranë

Ka marrë pjesë në koncerte të ndryshme realizuara në Austri, Gjermani, Itali, Zvicër, Danimarkë, Spanjë, Bullgari, Greqi, Maqedoni dhe, natyrisht Shqipëri.



## Nora Çashku

Pianiste

Ka filluar mësimet në piano që në moshë të vogël në Liceun Artistik "Jordan Misja" duke u dalluar për talentin dhe tiparet e veçanta të lojës në piano.

Që në moshë fare të re provoi emocionet e skenës në koncertet e ndryshme që ajo realizonte në kuadrin e aktiviteteve të shkollës, të larmishme dhe të shumta për atë kohë.

Nën udhëheqjen e Prof. M. Kristidhi fillon studimet në Akademinë e Arteve Tiranë për ti vazhduar më tej në Konservatorin Shtetëror "Çiprian Porumbesku" të Rumanisë.

Realizon një sërë koncertesh brenda dhe jashtë vendit me artisë elitare shqiptarë nga ku koncerte të shumta janë emtuar dhe transmetuar nga Radio-Televizione të ndryshme.

Regjistrime të lojës së saj si pianiste soliste janë në shumë kolona zanore të filmave shqiptarë si dhe të emtuar në CD dhe janë në fondin aktiv të RTSH. Shumë pjesë pianistike të mjeshtrove kompozitorë: Harapi, Zadeja, etj. transmetohen në mënyrë frekvente në Radio-Tirana.

Ka një bashkëpunim të rëndësishëm me të gjitha orkestrat shqiptare dhe ngushtë me dirigjentët e tyre Gjoni, Krante, Deda, Koço, Afezulli, Barbullushi, etj.

Për aktivitet cilësor pedagogjik ajo është nderuar me tituj dhe urdhëra të ndryshëm shtetëror. Shumë nga studentët ndër vite përbëjnë plejadën e pianistëve me zë të cilët marrin pjesë në aktivitetet elitare muziore brenda dhe jashtë vendit.

Aktualisht është pedagoge dhe drejtuese e Katedrës së pianos në Akademinë e Arteve të Bukura Tiranë.



**Petrika Afezulli**

*Dirigjent*

Është diplomuar për dirigjim në vitin 1988 në Akademinë e Arteve në klasën e Prof. Mustafa Krantja. Ciklin e plotë të shkollës fillore, tetëvjeçare dhe të mesme e ka përfunduar në vitin 1984 për piano.

Në periudhën 1988-1991 është dirigjent i orkestrës filarmonike dhe të harqeve "Aleksandër Moisiu" të qytetit të Durrësit. Gjatë kësaj periudhe merr pjesë në të gjitha aktivitetet kombëtare të muzikës simfonike dhe asaj të dhomës, organizuar nga Ministria e Kulturës. Më 1991 fiton koknkursin për pedagog dirigjent në katedrën e Dirigjimit në Akademinë e Artëve, vend pune që e mban deri më sot. Më 1997 kryen një kurs intensive specializimi në Konservatorin Superior të Parisit. Më 1998 në Festivalin Ndërkombëtar të Fivizzano-s ekzekuton me orkestrën e harqeve të Durrësit veprën fituese të çmimit të parë "Rondo" me autor V. Tole. Më 2001 bëhet anëtar i Fondacionit Ndërkombëtar "Musica Mundi". Më 2002 merr titullin As.Prof.

Gjatë periudhës 1991-2010 dallohet bashkëpunimi me Orkestrat Shqiptare si ajo e RTSH, TOB, AA si dhe ork. e Operas dhe Filarmonisë së Kosovës. Në repertorin e tij dallohen emrat e më shumë se 40 autorëve të huaj dhe shqiptarë, ku përfshihen gjithë stilet e interpretimit muzikor.

Dallojnë veprat e egzekutuara në pjesën më të madhe të repertorit të Hajden, Mozart, Beethoven, Shubert, Mendelson, Grig, Sibelius, Elgar, Çajkovski, Prokofiev, Shoshtakoviç si dhe të atyre shqiptar Zadeja, Ibrahim, Gaqi, Kushta, Laro, Lara, Zoraqi, Zacharian etj. Ka bërë mjaft regjistrime në Radiotelevizion me orkestrën e këtij institucioni si dhe me Teatrin e Operas dhe baletit. Është prodhues i tre CD-ve me orkestrën e harqeve "Aleksander Moisiu" dhe ork. "Tingujt e rinj".

Eshtë egzekutues i më shumë se 50 koncerteve dhe premierave të plota simfonike. Ka shumë bashkëpunime me artistë të shquar shqiptar si Nora Çashku, Astrit Selita, Vaso Papa, Florian Vlasi, Suzana Frashëri, Suela Piciri, Bashkim Barbullushi, Pirro Sota, Fatos Jaho, Arjan Paço, Kristina Laço, Xheni Afezulli, Dorina Laro, Elvis Rudi, Marin Gjollma etj si dhe instrumentistë të huaj si Till Engel (Gjermani), Gerald Frey (France), Wolfgang Pamholfer (Austri), Gioigos Konstantinou (Greqi), Vaso Ristov (Maqedoni) etj. Në fushën pedagogjike është udhëheqës i mbi 25 diplomave të studentëve dirizhorë.

# Koncert

## ACADEMY GRAND-GALA

# PROGRAMI

1. **F. SCHUBERT**

Ave Maria

Këndon

2. **G. VERDI**

Ballo me maska Aria e Amelias  
Morro ma prima Ingrazia

**Suzana FRASHËRI**  
Soprano

3. **A. CERICOLA**

Scre di tate

*Orkestroj Robert RADOJA*

4. **HENDEL**

Ombra mai fu

*Orkestroj Endri SINA*

Këndon

5. **G. PUCCINI**

Gianni schicchi

O mio babbino caro (Lauretta)

Opereta Princesha e Çardashit

Silvia

**Shqipe ZANI**  
Soprano

6. **E. CALMAN**

7. **A. CATALANI**

La wally

8. **G. PUCCINI**

Turandot - Tu che di sei cinta

Aria Lius

Castadiva

Nga opera **Norma**

Këndon

**Mariana LEKA**  
Soprano

9. **V. BELLINI**

10. **A. PAPARISTO**

Këngë e lashtë

*Orkestroj H. ZACHARLAN*

Humoreska

Në Piano

**Nora ÇASHKU**

11. **P. JAKOVA**

Margjelo

*Orkestroj Arjan AVRAZI*

Romanca e Adrianës

*Io son l'umile ancella*

*Orkestroj Robert RADOJA*

Nga opera **Adriana le couvreur**

Ti vashë mos këndo

*Orkestroj Kujtim LARO*

Këndon

**Suzana FRASHËRI**  
Soprano

12. **F. CILEA**

13. **S. RACHMANINOFF**

Ti vashë mos këndo

*Orkestroj Kujtim LARO*

14. **G. GERSHWIN**

Liza

*Orkestroj Hajg ZACHARLAN*

Zambaku i Prizrenit

Zare

*Orkestroj Zef ÇOBA*

Këndon

**Shqipe ZANI**  
Soprano

15. **A. KOÇI**

16. **L. GJOKA**

17. **POPULLORE**

18. **G. VERDI**

19. **J. STRAUSS**

20. **TH. GAQI**

Nat'Zaman të asaj furie

Ballo me maska - Oscar

Die fledermaus - Uverture

E duam Shqipërinë

Potpuri korçare

*Orkestroj Zef ÇOBA*

O sole mio

Radecki marsh

Orkestrale

Këndon

**Mariana LEKA**  
Soprano

21. **DI CAPUA**

22. **J. STRAUSS**

Shoqëron Orkestra Simfonike e Akademisë së Arteve  
Dirigjent: Petrika AFEZOLLI